



*100 Vjet Pavarësi*

# Raporti Vjetor

“Mbi aktivitetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”



2011



*100 Vjet Pavarësi*



## PËRMBAJTJA

- Mesazh përshëndetës i Kryetarit të Këshillit Administrativ të ISSH-së.
- Mesazh përshëndetës i Drejtores së Përgjithshme të ISSH-së.
- Profili i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- Struktura administrative e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
- Legjislacioni.
- Marrëdhënie ndërkombëtare.
- Përfitime.
- Kontribute.
- Zhvillimi i burimeve të informacionit.
- Arkivi Qendror i sigurimeve shoqërore.
- Aktiviteti financiar.
- Informimi dhe marrëdhëniet me publikun.
- Administrimi i burimeve njerëzore dhe investime.



### I nderuar lexues!

Procesi i integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian përballi Institucionet Shqiptare me shumë sfida. Viti 2011 do të evidentohet si një ndër më të rëndësishmit për sa i përket modernizimit të punës së Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të politikave dhe nismave të Qeverisë për përmirësimin në vazhdimësi të jetës dhe shërbimeve ndaj qytetarëve.


Më lejoni të theksoj se, edhe gjatë vitit 2011, i cili konsiderohet si vit financiarisht i vështirë

në rajon e më gjerë, pensionet urbane u rritën me 4%, ndërsa ato rurale me 7%, dhe si rrjedhojë transfertat në drejtim të buxheteve familjare arritën në 78.775 milionë lekë. Krahas rritjes së pensioneve, vëmendja jonë është përqendruar edhe në përmirësimin e elementëve të menaxhimit të skemës dhe modernizimit të sigurimeve, çka do të bëjë të mundur përmirësimin e shërbimit dhe rritjen e transparencës ndaj përfituesve, kontribuesve si dhe administrimin financiar të saj.

Ngritja e Drejtorisë së Arkivit Qendror të sigurimeve shoqërore është një ndër hapat më të rëndësishëm drejt menaxhimit të dokumentacionit të vjetërsisë në punë. Falë dixhitalizimit të të gjithë dokumentacionit të grumbulluar do të bëhet e mundur përfitimi i një produkti të sigurtë, si dhe do t'iu ofrohet shërbim i shpejtë qytetarëve. Për këtë qëllim, Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore miratoi Rregulloren nr. 8, datë 04.03.2011 "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Arkivit Qendror të sigurimeve shoqërore".

Në zbatim të rekomandimeve të Raportit Analitik të Komisionit European, nëntor 2010, si dhe rekomandimeve të Nënkomiteteve të Stabilizim-Asociimit, 2010, 2011, ISSH modernizoi sistemin informatik, duke u përgatitur kështu për të marrë pjesë në sistemin e EESSI (Shkëmbimi elektronik i informacioneve të sigurimeve shoqërore në EU). Përfundimi i këtij procesi do të rrisë transparencën e Institutit të Sigurimeve Shoqërore ndaj klientëve, duke iu dhënë mundësi atyre të marrin shërbimet e kërkuara në kohë reale dhe me siguri maksimale.

Gjithashtu, duhet theksuar dhe puna e bërë në drejtim të miradministrimit të skemës së pensioneve dhe mbledhjes së kontributeve. Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si një institucion i konsoliduar, ka punuar për fuqizimin e qëndrueshmërisë financiare të skemës, rritjen e numrit të kontribuesve në këtë skemë, gjithëpërfshirjen e emigrantëve shqiptarë kudo që ndodhen në skemën e sigurimit vullnetar, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe shmangien e abuzimeve me fondet e sigurimeve shoqërore.

  
Ridvan Bode  
Kryetar i Këshillit Administrativ të ISSH-së

Mirëmenaxhimi i skemës së sigurimeve shoqërore është një punë e përditshme e të gjithë stafit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në respekt të të gjithë qytetarëve shqiptarë, kontribues apo përfitues. Edhe gjatë vitit 2011 kemi vijuar me përkushtim komunikimin dhe shërbimin, duke përmirësuar tregues të rëndësishëm, si në drejtim të periudhës së lidhjes së pensioneve, ashtu edhe në drejtim të pastrimit të skemës nga çdo përfitim i paligjshëm.

Zbatimi i Projektit “Për informatizimin e sistemit të sigurimeve shoqërore”, i financuar nga Qeveria shqiptare dhe Banka Botërore nisi si domosdoshmëri për të forcuar dhe përmirësuar menaxhimin e skemës aktuale të sigurimeve shoqërore, duke i dhënë mundësinë kujtdo që të njihet në çdo kohë me vlerat e tij kontributive, si dhe me masën e përfitimit që do të ketë. Ky hap përfshiu nisjen e procesit për hedhjen në sistem të të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me vjetërsinë në punë të shtetasve shqiptarë dhe krijimin e regjistrit kombëtar të pensioneve, duke filluar kështu rrugën drejt sistemit të krijimit të llogarive personale për çdo kontribues dhe llogaritjes online të përfitimeve.

Në këtë proces, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka bashkëpunuar ngushtë me Postën Shqiptare sha, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Bankat e nivelit të dytë dhe Zyrat e Gjendjes Civile.


Një urë e rëndësishme për realizimin e këtyre synimeve ka qenë vendimi i Qeverisë për të ndërtuar Arkivën e Centralizuar të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, duke bërë të mundur mbledhjen dhe menaxhimin e dokumentacionit nga strukturat e saj.

Mbështetur në një dinamikë të gjerë ndryshimesh stafi ynë ka synuar që përmes punës së përditshme të shtojë transparencën me kontribuesit dhe përfituesit e skemës, të japë informacion në kohë reale për gjithçka ndodh përse i përket marrëdhënies me qytetarët. Këto hapa kanë bërë të mundur rritjen e besimit të gjithsecilit në skemën e pensioneve.

Objektiv i rëndësishëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore ka qenë edhe përmirësimi në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare me qëllim konsolidimin e mëtejshëm të tyre, integrimin e skemës, rritjen e hapësirës ligjore dhe administrative për mbrojtjen dhe mbulimin e emigrantëve nga skema e sigurimeve shoqërore, si dhe nxitjen e intensifikimit e punës për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mbrojtjes sociale.

Unë dhe stafi që drejtoj jemi të bindur se, informatizimi i të gjitha të dhënave për çdo kontribut të derdhur, si dhe dhënia e çdo përfitimi në mënyrë të informatizuar, do t'i afrojë gjithnjë e më shumë qytetarët me skemën, duke i bërë bashkudhëtarë të rëndësishëm të çdo ndryshimi që kemi ndërmarrë.


Vjollca Braho  
Drejtoreshë e Përgjithshme e ISSH-së



## PROFILI I INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion që realizon të drejtën e shtetasve për mbrojtje shoqërore në Republikën e Shqipërisë. Ai u krijua në Qershor të vitit 1992, me Vendim të Këshillit të Ministrave<sup>1</sup>, për të administruar sistemin e sigurimeve shoqërore. Skema aktuale e sigurimeve të detyrueshme shoqërore në Shqipëri filloi në vitin 1993 me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”<sup>2</sup>. Ajo është një skemë jo fitimprurëse, e ndërtuar mbi parimin “pay-as-you go”, parimin e vetëpërgjegjësisë së individit për rrisqet e së ardhmes dhe parimin e solidaritetit midis brezave.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është institucion publik, shtetëror e i pavarur dhe drejtohet nga një Këshill Administrativ tripalësh, me përfaqësues të Qeverisë<sup>3</sup>, të Punëmarrësve dhe të Punëdhënësve dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Aktivitetin e tij, Instituti i Sigurimeve Shoqërore e realizon nëpërmjet zyrave rajonale dhe agjensive lokale, që shtrihen në të gjithë territorin e Shqipërisë.



<sup>1</sup> VKM nr.249, datë 5.6.1992 “Për krijimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”

<sup>2</sup> Ligji hyri në fuqi më 1 Tetor 1993

<sup>3</sup> Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Drejtësisë dhe Instituti i Statistikave



## PËRBËRJA E KËSHILLIT ADMINISTRATIV TË ISSH-së

Kryetar



**Ridvan BODE**  
*Ministër i Financave*

Nënkryetar



**Gezim KALAJA**  
*Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH)*



**Ismail VAROSHI**  
*Konfederata e Organizatave të Punëdhënësve (KOP)*


Anëtarë



**Kastriot SULKA**  
*Zëvendësministër i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta*



**Elvana HANA**  
*Drejtoresh e Përgjithshme e ISSH-së*



**Marsida XHAFERLLARI**  
*Drejtoresh e Përgjithshme e Drejtorisë së Kodifikimit, Ministria e Drejtësisë*





**Besian PESHA**  
*Drejtor i Drejtorisë së Administrimit të  
Pronës Publike, Ministria e Ekonomisë*



**Ines NURJA**  
*Drejtoreshë e Përgjithshme e Institutit  
të Statistikave*



**Bashkim SALA**  
*Bashkimi i Organizatave të  
Biznesit Shqiptar (BOBSH)*



**Avenir KIKA**  
*Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë*




**Zija HASANAJ**  
*Konfederata e Sindikatave të  
Shqipërisë (KSSH)*



**Eshtem GRACI**  
*Unioni i Sindikatave të Punonjësve  
të Shqipërisë (USPSH)*



# STRUKTURA ADMINISTRATIVE E INSTITUTIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE



## LEGJISLACIONI

Përafrimi i legjislacionit të sigurimeve shoqërore gjithnjë e më shumë me standartet europiane ka sjellë përmirësime si në fushën e kontributeve dhe në atë të përfitimeve të sigurimeve shoqërore. Kjo ka bërë të mundur zgjerimin e rrethit të personave të mbrojtur, rritjen dhe shtimin e nivelit dhe llojit të përfitimeve. Gjatë vitit 2011, u bënë një sërë ndryshimesh, si më poshtë:

### Në fushën e kontributeve

- Ligji nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, mundësoi faljen e një pjese të kontributeve të sigurimeve shoqërore, si dhe faljen e gjobave dhe të kamatëvonesave, në përputhje me statusin e subjekteve;
- Këshilli i Ministrave, për vitin 2011, përcaktoi masën e kontributit për sigurimet shoqërore në qytet e në fshat, me anë të VKM nr. 541, datë 27.07.2011.

### Në fushën e përfitimeve

- Ligji nr. 10447, datë 14.07.2011, përcaktoi një mënyrë të re të konstituimit të KMCAP-ve Eprore (Komisioneve Eprore Mjeksore të Caktimit të Aftësisë për Punë të të sëmurëve dhe invalidëve), përmes amendamenteve që iu bënë Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 471, datë 02.07.2011 «Për rritjen e pensioneve». Me këtë Vendim u rritën pensionet në qytet e fshat, në zbatim të programit të Qeverisë dhe Ligjit për buxhetin e shtetit për vitin 2011, si dhe u rriten pensionet suplementare e trajtimet e veçanta, sipas statuseve;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 03.08.2011 «Për indeksimin e bazës individuale për llogaritjen e pensionit vjetor fillestar», i cili përcaktoi koeficientin e indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor, individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve, si rrjedhojë e kontributeve të mbledhura një vit më parë, vendim i cili del çdo vit, si detyrim i parashikuar në ligjin e sigurimeve shoqërore;
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.541, datë 27.07.2011 “Për disa ndryshime në VKM 1114, datë 30.07.2008 “Për disa çështje në zbatim të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar, Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar dhe Ligjit nr. 7870, datë 13.10.1994 «Për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar. Ky vendim përcaktoi nivelin bazë të pensioneve urbane dhe rurale, për vitin 2011.



## MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të neneve 48 dhe 99 të Marrëveshjes të Stabilizim - Asociimit, e cila hyri në fuqi në 1 Prill 2009, ka vazhduar me prioritet punën në drejtim të koordinimit të skemës të sigurimeve shoqërore.

Konsolidimi i mëtejshëm i marrëdhënieve me qëllim integrimin e skemës, rritja e hapësirës ligjore dhe administrative për mbrojtjen dhe mbulimin e emigrantëve nga skema e sigurimeve shoqërore, nxitja dhe intensifikimi i punës për nënshkrimin e marrëveshjeve bilaterale në fushën e mbrojtjes sociale, kanë qenë objektivat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Për të realizuar këto objektiva, gjatë vitit 2011, ISSH vazhdoi zbatimin e Marrëveshjes për Mbrojtjen Shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Republikës të Turqisë, e cila ka hyrë në fuqi nga 15.04.2005, duke realizuar të drejtat e shtetasve shqiptarë dhe turq për njohjen e bashkimit e periudhave të kontributimit të sigurimeve shoqërore në të dy vendet. Gjatë viti 2011 krahas qytetarëve shqiptarë, që jetojnë ose kanë punuar në Turqi, janë rritur kërkesat për verifikim të periudhave kontributive nga Institucioni turk për të punësuarit turq në Shqipëri. Gjatë vitit 2011 janë ndjekur rreth 120 procedura nga 84 në 2010, në zbatim të Marrëveshjes dhe në përputhje me rregullat e vendosura në Marrëveshjen Administrative. Në 22-23 shkurt 2011, në Ankara, një delegacion i Institutit të Sigurimeve Shoqërore zhvilloi bisedime me përfaqësues të Institucioneve Homologe Turke, lidhur me çështje të zbatimit të Marrëveshjes, ku u konkludua se Palët iu janë përgjigjur detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja në mënyrë profesionale dhe korrekte, e cila përbën arritje për ISSH-në, për faktin se është marrëveshja e parë që ajo zbaton.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është angazhuar dhe ka nënshkruar Protokolle Bashkëpunimi me institucionet homologe italiane, që t'iu ofrojë informim (pa pagesë) për fushën e mbrojtjes shoqërore emigrantëve shqiptarë në Itali. Në mungesë të Marrëveshjes në fushën e sigurimeve shoqërore midis dy vendeve, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka krijuar kushte që, duke jetuar e punuar në Itali, emigrantët shqiptarë të mundin të plotësojnë periudhat e nevojshme për të përfituar pension në Shqipëri. Në kuadër të zgjerimit të bashkëpunimit me Sindikatat Italiane, në datat 3-4 mars 2011 u realizua në Romë takimi mes drejtuesve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit Kombëtar Italian të Asistencës Sociale (INAS-it). Në këtë aktivitet pala italiane ofroi mundësinë që të shpërndajë informacion falas për emigrantët shqiptarë, për periudhat e sigurimit në Shqipëri dhe plotësimin e dokumenteve nga mbi 800 zyrat e tij në gjithë Italinë.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizoi në datë 22.02.2011 Marrëveshjen me Bankën “Intesa Sanpaolo Bank Albania” “Për arkëtimin e kontributeve të sigurimit vullnetar të ISSH-së, për shtetasit shqiptarë me banim në Itali”. Kjo Marrëveshje bën të mundur që emigrantët shqiptarë në Itali të realizojnë kontratat e sigurimit vullnetar dhe të paguajnë kontributet në vendet ku ata banojnë në Itali, pranë sporteleve të kësaj Banke.

Nga data 27-29 qershor 2011, në Bruksel, u zhvillua raundi i i dytë i bisedimeve dypalëshe për realizimin e marrëveshjes për mbrojtjen shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Mbretërisë të Belgjikës. Në Belgjikë ka rreth 10.000 emigrantë shqiptarë.

Në 10-14 tetor 2011, në Budapest, Hungari, u zhvillua raundi i parafundit i negociatave për marrëveshjen për sigurimet shoqërore midis Republikës të Shqipërisë dhe Hungarisë.

Negociatat për realizimin e një marrëveshjeje për mbrojtjen shoqërore kanë filluar në 19-20 maj 2011, me raundin e parë të bisedimeve, edhe me Republikën e Maqedonisë.

## MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE

Garantimi i të drejtave dhe shpejtësia në lidhjen e përfitimeve kanë qenë dhe mbeten prioritet kryesor i Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Përfitimet nga skema e sigurimit të detyrueshëm mbështeten në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Kjo skemë mbron me të ardhura të gjithë personat e siguruar në rastin e pakësimit të tyre si rezultat i:

- Paaftësisë së përkohëshme në punë për shkak të sëmundjes;
- Barrë lindjes;
- Pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe pensionit familjar, që rrjedh nga humbja e mbajtësit të familjes;
- Aksidentit në punë dhe sëmundjeve profesionale;
- Papunësisë.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si institucioni më i specializuar i sistemit të mbrojtjes sociale, është ngarkuar me Ligj që krahas skemës së detyrueshme, të administrojë dhe të shpërndajë përfitime të tjera që rrjedhin nga ligje specifike, si përfitime suplementare për punonjësit me funksione kushtetuese dhe të shtetit, përfitime suplementare të ushtarakëve dhe përfitime që rrjedhin nga statute e ligje te veçanta.

### Politikat e zbatuara në fushën e pensioneve për vitin 2011

Në kuadër të programit të Qeverisë për përmirësimin e nivelit të jetesës së pensionistëve, masa mujore dhe të ardhurat mujore të pensionistëve për vitin 2011 pësuan sërish rritje. Me VKM nr. 471, datë 02.07.2011 “Për rritjen e pensioneve” u rritën:

- Në masën 4% pensionet urbane të pleqërisë, të invaliditetit dhe ato familjare;
- Në masën 7% pensionet rurale të pleqërisë, invaliditetit dhe familjare.

Si rezultat i këtyre rritjeve, kanë përfituar 548,600 pensionistë, me një efekt financiar vjetor prej 1,634 milionë lekë.

Foto LSA







### Rritja e masës së pensioneve dhe e të ardhurave të pensionistëve nga 01.07.2011

	pensione urbane	pensione rurale
<b>Masa e pensioneve</b>		
Pensioni minimal i pleqërisë	11,117	7,468
Pensioni mesatar i plotë i pleqërisë	13,278	7,859
Pensioni maksimal i pleqërisë	22,234	11,117
<b>Të ardhurat e pensionistëve</b>		
Të ardhurat për pensionin minimal të pleqërisë	13,267	8,358
Të ardhurat për pensionin mesatar të plotë të pleqërisë	14,790	8,468
Të ardhurat për pensionin maksimal të pleqërisë	22,734	11,317

### Niveli minimal për pensionet e pleqërisë, urbane dhe rurale, si dhe kompensimet që kanë përfituar pensionistët sipas të gjitha Vendimeve të Këshillit të Ministrave, për periudhën 2005-2011

	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhurat minimale për pensionistët urbanë	8,350	10,000	10,410	11,275	12,226	12,840	13,267
Pensioni minimal i pleqërisë urban	7,850	8,240	8,650	9,515	10,276	10,690	11,117
Kompensimi i energjisë elektrike	350	350	350	350	350	350	350
Kompensimi i bukës	150	150	150	150	150	150	150
Kompensimi VKM nr. 401		500	500	500	500	500	500
Kompensimi VKM nr. 763		760	760	760	760	760	760
Kompensimi VKM nr. 415					190	190	190
Kompensimi VKM nr. 474						200	200
Të ardhurat minimale për pensionistët ruralë	3,630	4,310	5,410	6,090	7,234	7,870	8,358
Pensioni minimal i pleqërisë rural	3,430	4,110	4,520	5,200	6,344	6,980	7,468
Kompensimi i energjisë elektrike	200	200	200	200	200	200	200
Kompensimi VKM nr. 17			690	690	690	690	690

## Ndryshimet me tendencë në rritje të të ardhurave minimale në vite për pensionet urbane dhe rurale



Përfitimet, në varësi të kohëzgjatjes së tyre ndahen në:

### Përfitime afatgjata

Periudha e dhënies së këtyre përfitimeve zgjat mbi 1 vit. Në këto kategori përfitimesh përfshihen pensionet e pleqërisë, invaliditetit dhe ato familjare.



Aktualisht, skema e sigurimeve shoqërore trajton pensionet urbane dhe pensionet rurale<sup>4</sup>

Për vitin 2011, skema e detyrueshme ka trajtuar me përfitime afatgjata të të gjitha llojeve 548,675 persona, nga këto 390,956 pensione urbane dhe 157,719 pensione rurale.

Në pensionet e pleqërisë përfshihen: pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i pjesshëm i pleqërisë, pensioni i reduktuar i pleqërisë.

- Pensionet e pleqërisë përbëjnë grupin më të madh të përfituesve, me rreth 78.2% të tyre, ose 429,309 pensione, duke përfshirë të dy llojet e pensioneve urbane dhe rurale, prej të cilëve 288,533 pensione pleqërie urbane dhe 140,776 pensione pleqërie rurale;
- Pensionet e invaliditetit zenë rreth 10.7% të pensioneve gjithsej ose 58,685 persona, prej të cilëve 52,023 invalidë urbane dhe 6,662 invalidë rurale;
- Pensionet familjare përbëjnë 11.1% të pensioneve gjithsej ose 60,681 pensione, prej të cilave 50,400 pensione familjare urbane dhe 10,281 pensione familjare rurale.

### Pesha specifike që zë çdo kategori në secilin nga llojet e pensioneve urbane dhe rurale






## Përfitimë afatshkurtra

- Paaftësi e përkohshme në punë: periudha e përfitimit zgjat nga 15 ditë deri në 6 muaj, si pasojë e sëmundjes së përgjithshme dhe deri në 1 vit, si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundjeve profesionale. Në këto përfitimë përfshihen: të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga sëmundje të përgjithshme dhe të ardhura për paaftësi të përkohëshme nga aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- Paaftësi e përkohëshme nga sëmundjet e përgjithshme: për vitin 2011 janë trajtuar me paaftësi të përkohëshme në punë nga sëmundje të përgjithshme 3,821 raste, nga të cilat 1,001 në sektorin buxhetor, 499 raste në sektorin jobuxhetor dhe 2,321 raste në firmat private;
- Paaftësi e përkohëshme nga aksidenti në punë dhe sëmundje profesionale: të ardhurat për paaftësi të përkohëshme nga aksidenti në punë apo sëmundjet profesionale jepen në momentin kur vërtetohet aksidenti apo sëmundja profesionale. Për vitin 2011 janë trajtuar me paaftësi të përkohëshme në punë si pasojë e aksidentit në punë apo sëmundje profesionale 57 raste, nga të cilët 8 raste në subjektet buxhetore, 5 në subjektet jobuxhetore dhe 44 raste në firmat private;
- Barrë lindje: përfitimi për barrë lindje i jepet një gruaje të siguruar, lidhur me barrën dhe lindjen e fëmijës, kur ka jo më pak se 12 muaj sigurim, për çdo rast barrë lindjeje. Për vitin 2011 janë trajtuar me përfitim për barrë lindje 11,791 raste, nga të cilat 1,742 në subjektet buxhetore, 411 në subjektet jobuxhetore, 3,715 në firmat private, 1,025 në të vetëpunësuarit në qytet dhe 4,898 raste nga të vetëpunësuarit në bujqësi.



Përfitues afatshkurtër sipas degëve të përfitimit gjatë vitit 2011




## Ecuria e treguesve individuale të sistemit të sigurimeve shoqërore

Këtu, me mjaft interes paraqitet shqyrtimi i ecurisë për disa vite i disa treguesve analitikë të sistemit, si ecuria e masës së pensionit dhe e të ardhurave individuale të pensionistit, norma e zëvendësimit, norma e varësisë së sistemit, si dhe shkalla e mbulimit.

Përfitimet mujore nga pensionet përgjithësisht paraqesin ritëm të ngadaltë të rritjes së tyre në vite. Ndërsa në 5 vitet e fundit, politikat e pensioneve, si dhe vendosja e një skeme të re kompensimi për përfituesit me të ardhura minimale, ka sjellë si pasojë rritjen dhe përmirësimin e të ardhurave të pensionistëve. Krahasuar me vitin 2001, në vitin 2011 evidentohet një rritje e të ardhurave të pensionistëve me 59% ndaj 22% që është rritja e nivelit të indeksit të çmimeve. Norma e zëvendësimit, e cila shpreh raportin midis masës së pensionit mesatar me pagën mesatare, gjatë periudhës 2001 – 2011 për skemën urbane ka ardhur duke u përkeqësuar, sidomos në vitet 2007 – 2009, pas rritjes me ritme të shpejta të pagës mesatare si pasojë e uljes së informalitetit në deklarimin e pagave, theksuar kjo pas hyrjes në fuqi të VKM nr. 285, datë 04.05.2007. Në 2 vitet e fundit, ky tregues ka paraqitur stabilitet, dhe në vitin 2011 ka arritur në 35.6% (37.4% për pensionet e plota).

Nga ana tjetër, në skemën rurale, norma e zëvendësimit është rritur gjatë gjithë kësaj periudhe, si rezultat i rritjes më të shpejtë të masës së pensionit të fshatit ndaj rritjes së pagës minimale kontributive, nga 15.7% në vitin 2001 në 41.5% në vitin 2011.

Puna e punonjësve të sigurimeve shoqërore e në veçanti e atyre që merren me administrimin dhe menaxhimin e pensioneve matet e vlerësohet nga përpjekjet që ata bëjnë për të shkurtuar në mënyrë të vazhdueshme kohën e nevojshme për caktimin e një pensioni. Kështu, për vitin 2011 janë shpenzuar mesatarisht 25.3 ditë për caktimin e një pensioni pleqërie, 21.6 ditë për caktimin e një pensioni invaliditeti dhe 22.8 ditë për pensionet familjare, ndërkohë që sipas Ligjit kërkohen mesatarisht 45 ditë, ndërsa për vitin 2010 janë harxhuar mesatarisht 37 ditë pune për caktimin e një pensioni. Shkurtimi i kësaj kohe mbetet objektiv i punonjësve të sigurimeve shoqërore për të arritur që çdo pensionist të mos ketë në kohë shkëputje të ardhurash nga dita e lënies së punës me ditën e tërheqjes faktike të këstit mujor të pensionit. Kjo do të realizohet përmes procesit të informatizimit të sistemit të sigurimeve shoqërore në tërësi e në veçanti informatizimit e automatizimit të procesit të llogaritjes së pensionit.



## Përfitimet suplementare

Sigurimi suplementar është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore. Aktualisht egzistojnë tri skema:


- Skema e sigurimit shtetëror suplementar;
- Skema e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve;
- Skema e trajtimeve të veçanta.

Qëllimi i skemave të sigurimit suplementar është që të japin përfitime suplementare si të ardhura shtesë mbi përfitimet që jepen nga skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror për personat që me ligje deklarohen subjekte të skemave respektive.

Në skemat e sigurimit suplementar dhe të trajtimeve të veçanta, gjatë vitit 2011 janë trajtuar gjithsej me përfitime rreth 27,100 persona, me një fond të programuar nga Buxheti i Shtetit prej 4,889 milionë lekë.

- Gjatë vitit 2011 në skemën e sigurimit shtetëror suplementar janë trajtuar me përfitime 1,419 persona. Kjo skemë është e detyrueshme përsa i përket pjesëmarrjes në të, për kategoritë e përcaktuara;
- Gjatë vitit 2011 nga skema e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve janë trajtuar me përfitime 19,876 persona, nga të cilët 11,975 përfitojnë pension suplementar ushtarak për vjetërsi shërbimi, 7,542 persona përfitojnë pension suplementar pleqërie si ish-ushtarakë dhe pjesa tjetër janë pensione suplementare invaliditeti dhe familjare. Skema e sigurimit shoqëror suplementar të ushtarakëve është një skemë që tashmë funksionon sipas Ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në RSH”, i ndryshuar, dhe trajton me përfitime suplementare ushtarakët e shërbimit aktiv të strukturave të përcaktuara në të. Skema financohet nga Buxheti i Shtetit dhe nga kontributet e të punësuarve në strukturat ushtarake përkatëse;
- Në skemën e trajtimeve të veçanta për vitin 2011 janë trajtuar me përfitime 5,826 persona, nga të cilët: ish-punonjës të nëntokës 3,770 persona; trajtime të familjeve përfituese nga Statusi “Dëshmor i Atdheut” 421 familje; ish-punonjës të ndërmarrjeve të industrisë ushtarake 760 persona; pilotët fluturues në pension 277 persona; ushtarakët detarë të nëndetëseve në pension 80 persona, si dhe 518 persona që përfitojnë nga Ligji nr. 10139, datë 15.05.2009 “Për pensionet shtetërore suplementare të punonjësve të Universiteteve, të Shkollave të larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”.

Përfitues në skemat suplementare gjatë vitit 2011



Fondet e kësaj skeme përballohen kryesisht nga Buxheti i Shtetit 86.9%, si dhe nga kontributet që derdhin personat e përfshirë në të 13.1%.

## KONTRIBUTET

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka ndjekur me përparësi sigurimin e detyrueshëm, shoqëror dhe shëndetësor të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe sigurimin vullnetar të personave të interesuar për të përfituar pension pleqërie.

Në zbatim të Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, në bashkëpunim me organet tatimore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka punuar për realizimin e të ardhurave nga pagesat e kontributeve të subjekteve publikë dhe privatë.

Në këtë kuadër, është punuar në drejtim të realizimit të të ardhurave të programuara për vitin 2011:

- Të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore, për sigurimet shoqërore të detyrueshme dhe suplementare, u realizuan me 48,397 milionë lekë, nga 50,010 milionë lekë të programuara, me një diferencë prej 1,613 milionë lekë ose 96.8%. Këtu mund të theksojmë se në vitin 2011, janë mbledhur 3,202 milionë lekë më shumë se gjatë vitit 2010;
- Plani i të ardhurave për fondin e sigurimeve shoqërore, nën përgjegjësinë e realizimit nga ISSH, nga 2,790 milionë lekë, u realizua 3,228 milionë lekë, me një tejkalim prej 438 milionë lekë ose 115.7%;
- Plani i të ardhurave nën përgjegjësinë e realizimit nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, u realizua 95.7%, nga 47,220 milionë lekë në 45,181 milionë lekë, me një mosrealizim prej 2,039 milionë lekë.

## Të ardhurat e programuara dhe realizimi i tyre për vitin 2011

në milionë lekë

	plan	fakt	ndryshimi	%
1 Subjekte juridike e fizike	47,220	45,181	-2,039	95.7
2 Të vetëpunësuar në bujqësi	2,224	2,413	189	108.5
3 Sigurimi vullnetar	381	377	-4	99.0
4 Të ardhura të tjera	185	426	241	230.3
<b>Totali</b>	<b>50,010</b>	<b>48,397</b>	<b>-1,613</b>	<b>96.8</b>

### Sigurimi i të vetëpunësuarve në bujqësi

Të ardhurat e programuara, nga pagesat e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi, për vitin 2011 u realizuan 108.5 % me një tejkalim prej 189 milionë lekë.

Në rritjen e të ardhurave dhe të pjesëmarrjes së vetëpunësuarve në bujqësi në skemën e sigurimeve shoqërore ndikoi pozitivisht Ligji nr. 10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”. Në zbatim të këtij Ligji, u likujduan detyrimet e vitit 2011 dhe përfituan faljen e detyrimeve të prapambetura gjithsej 21,884 të vetëpunësuar në bujqësi, me një shumë prej 486 milionë lekë, nga të cilat 409 milionë lekë kontribute dhe 77 milionë lekë kamatëvonesa.




### Sigurimi vullnetar

Të ardhurat e programuara nga pagesat e kontributeve të personave të siguruar vullnetarisht, për vitin 2011, u realizuan në masën 99%, ose 377 milionë lekë, me një mosrealizim prej 4 milionë lekë. Ndërsa në krahasim me vitin 2010 u realizuan 8 milionë lekë më shumë.

Përsa i përket personave të siguruar vullnetarisht në skemën e sigurimit vullnetar, mund të themi se numri mesatar i kontribuesve gjatë vitit 2011 arriti në 8,493 persona. Ndërsa numri fizik i kontribuesve, në fund të vitin 2011, rezultoi me 5,275 persona të siguruar vullnetarisht. Duke analizuar grupmoshën e personave fizikë të siguruar vullnetarisht, rezulton si më poshtë:

- Në numrin fizik të kontribuesve gjithsej, për vitin 2011, kontribuesit brenda vendit kanë zënë 58% dhe emigrantët kanë zënë 42%, pothuajse në të njëjtën raport si në vitin 2010;
- Në numrin e personave të siguruar, për vitin 2011, grupmoshat 18-30 vjeç zënë 6.4% ndërsa grupmosha 31-50 vjeç dhe grupmosha mbi 50 vjeç zënë pjesë thujse të barabarta përkatësisht nga 46.8%.

Kontribues të siguruar vullnetarisht sipas gjinisë dhe grupmoshës për vitin 2011



Në funksion të sigurimit vullnetar, është bërë një publicitet i vazhdueshëm si brenda vendit ashtu dhe për emigrantët tanë kudo që ndodhen. Në këtë kuadër, ka vazhduar bashkëpunimi me disa Patronate në Itali si “CISL”, “ACAI”, “ACLI”, “ENAS-UGL”, me të cilët është punuar për përfshirjen e emigrantëve shqiptarë në skemën e sigurimit vullnetar dhe konfirmimin e periudhave kontributive.


### Ulja e normës kontributive dhe influenca në rritjen e të ardhurave

Reduktimi i masës së kontributeve, për punëdhënësin dhe të vetëpunësuarin ka dhënë një ndikim pozitiv jo vetëm në rritjen e të ardhurave, por edhe në rritjen e numrit të të punësuarve në subjektet privatë juridikë e fizikë, si dhe në rritjen e numrit mesatar të kontribuesve për një subjekt.

### Të ardhurat në total dhe ecuria e normës së kontributit

	2007	2008	2009	2010	2011
Të ardhurat në milionë lekë	37,664	42,795	44,145	45,195	48,397
Norma e kontributit në % ndaj pagës	29.5	29.5	26.5	24.5	24.5
Rritja në %	5.3	13.6	3.2	2.4	7.1





## Realizimi i numrit të kontribuesve

Gjatë vitit 2011 numri mesatar i kontribuesve rezulton të jetë 5.9% më i lartë se një vit më parë, me 40,934 kontribues më shumë, si më poshtë:

### Pasqyra e numrit mesatar të kontribuesve për vitin 2011

	numër mesatar viti 2011	në % ndaj totalit	në % ndaj vitit 2010
sipas subjekteve	692,110	94.1	106.2
ndërmarrje buxhetore	139,177	18.9	104.7
ndërmarrje jobuxhetore	21,987	3	98.9
firma private	182,358	24.8	107.2
të vetëpunësuar	78,998	10.7	121.1
të vetëpunësuar në bujqësi	261,097	35.5	103.4
vullnetarisht	8,493	1.2	98
të siguruar nga shteti	27,669	3.8	92.8
përfitues afatshkurtër	15,669	2.1	121.4
<b>Numri i kontribuesve</b>	<b>735,448</b>		<b>105.9</b>


## Sektori urban

- Për subjektet publike rezultuan 161,164 kontribues dhe numri mesatar i personave të punësuar në subjekte publike arriti në 75 nga 73 që ishte në vitin 2010;
- Për subjektet private rezultuan 261,356 kontribues, nga 235,381 kontribues që ishin në vitin 2010 me një rritje prej 11% ose 25,975 kontribues më shumë, nga të cilët 12,237 kontribues në firmat private dhe 13,738 të vetëpunësuar. Kjo rritje u reflektua edhe në rritjen e numrit mesatar të personave të punësuar në një firmë private, nga 10 persona gjatë viti 2010, arriti në 12 persona.

## Të vetëpunësuarit në bujqësi

Gjatë vitit 2011 numri i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi, të llogaritur në vite-njerëz-kontribute, arriti në 261,097 kontribues, dhe krahasuar me vitin 2010 u rrit me 3.4% ose 8,493 kontribues më shumë. Ndërsa numri i të vetëpunësuarve fizikë të siguruar arriti në 87,879 persona, nga të cilët 66,032 ose 75% ishin të vetëpunësuar në zonat fushore dhe 21,847 ose 25% ishin të vetëpunësuar në zonat malore. Duke bërë një analizë të numrit të të vetëpunësuarve fizikë të siguruar sipas grupmoshave, për vitin 2011, rezulton se:

- Personat deri në moshën 30 vjeç zënë rreth 11.6% të numrit të përgjithshëm të të siguarve, ç'ka tregon se sigurimi i moshave të reja ze një vend relativisht të vogël dhe në këtë grup, predominon sigurimi i grave për të përfituar barrë lindje;
- Personat e grupmoshës nga 31-60 vjeç zënë 81.9% të numrit të përgjithshëm të të siguarve dhe në këtë grup predominon sigurimi i kontribuesve në vazhdimësi të sigurimit dhe kontribuesve që kërkojnë të plotësojnë periudhën prej 35 vjet të siguruar, që nevojitet për një pension të plotë pleqërie.



## Pakësimet e detyrimeve të prapambetura dhe efektet e zbatimit të ligjit të faljes së kamatëvonesave

Gjatë vitit 2011, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka ndjekur pakësimin e detyrimeve të prapambetura të subjekteve jobuxhetorë, të firmave private dhe të vetëpunësuarve dhe efektet e zbatimit të ligji nr.10418, datë 21.04.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”.



## Pasqyrë përmbledhëse e pakësimit të detyrimeve gjatë periudhës janar – dhjetor 2011

në milionë lekë

	Numri i subjekteve	Detyrime të shlyera gjithsej	Nga këto:	
			Kontribut	Kamatë
Gjendja më 01.01.2011	1,363	984	523	461
Shtesat e periudhës	6	1	1	0
Pakësimet e periudhës	531	448	18	430
Gjendja më 31.12.2011	838	536	505	31

Për periudhën Janar-Dhjetor 2011 numri i subjekteve debitore është ulur me 531 subjekte, për shumën e detyrimeve të prapambetura prej 448 milionë lekë, nga të cilat 18.2 milionë lekë kontribute dhe 429.8 milionë lekë kamatëvonesa. Vlen të theksohet se kryesisht, ulja e numrit të subjekteve debitorë ka ardhur si rrjedhojë e zbatimit të Ligjit të faljes së kamatëvonesave, nga i cili kanë përfituar faljen e detyrimeve të prapambetura rreth 436 subjekte debitorë, kryesisht të vetëpunësuar, për shumën e detyrimeve të prapambetura prej 441.7 milionë lekë, nga të cilat 13.3 milionë lekë kontribute dhe 428.4 milionë lekë kamatëvonesa.

### Baza e të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë kordinuar punën për krijimin e bazës së të dhënave për të vetëpunësuarit në bujqësi për periudhën 1993 - 2011, të ndarë në bazën e të dhënave të periudhës 1993 - 2005, e cila është drejt përfundimit dhe bazën e të dhënave të periudhës 2006 - 2011, e cila ka përfunduar, ku përfshihen të dhëna analitike për rreth 510 mijë të vetëpunësuar në bujqësi, të cilët kanë prekur skemën e sigurimeve shoqërore gjatë këtyre viteve.

## ZHVILLIMI I BURIMEVE TË INFORMACIONIT

Në mbështetje të strategjisë për informatizimin e të gjithë sistemit të sigurimeve shoqërore, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, gjatë vitit 2011, është angazhuar me një sërë detyrash dhe projektesh. Pas ndërtimit të strategjisë afatmesme të detajuar, në të cilën është parashikuar mënyra se si do të kryhet informatizimi, u përcaktua arkitektura që do të implementohet, nevojat për hardware dhe software, fazat që do të ndiqen, prioritetet për pjesë të veçanta të sistemit të integruar, koha kur do të realizohen dhe kostot përkatëse. Kjo strategji, gjatë vitit 2011 ka konsistuar në:

- Dixhitalizimin e të gjithë informacionit gjendje, që është në letër, për kontribuesit dhe pensionistët;
- Automatizimin e proceseve të llogaritjes së përfitimeve, që ofron sistemi i sigurimeve shoqërore;
- Informatizimin e sistemit financiar të sigurimeve shoqërore;
- Informatizimin e sistemit të pagesave të përfitimeve;
- Informatizimin e sistemit të menaxhimit të kontributeve.
- Sistemi informatik i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është projektuar si dy sisteme të integruar tek njëri-tjetri:
- Sistemi i arkivës dixhitale;
- Sistemi i informatizuar i aktivitetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që konsiston në llogaritjen dhe pagimin e të drejtave të konstatuara dhe atyre që lindin çdo ditë.

Ky sistem është projektuar në bashkëpunim me ekspertë të Bankës Botërore duke patur parasysh teknologjinë më të fundit dhe specifikat e sistemit shqiptar dhe sipas standarteve të Bashkimit European në fushën e koordinimit e shkëmbimit të informacioneve për sigurimet shoqërore.

Gjatë vitit 2011 përfundoi:

- Softi për llogaritjen e përfitimeve dhe infrastruktura hardware për sistemin e informacionit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Sistemi financiar me të gjithë komponentët e tij;
- Softi për menaxhimin e kontributeve për të gjitha kategoritë e kontribuesve urbanë, fermerë, vullnetare.

Gjithashtu, gjatë viti 2011 u hodhën bazat dhe është në proces zhvillimi i sistemit të informacionit të Arkivës kombëtare dixhitale dhe infrastrukturës hardware për këtë system si server, storage, network etj. Përfundimi i këtij projekti do të bëjë të mundur:

- Rritjen e transparencës ndaj publikut në lidhje me kontributet e paguara. Qytetarët do të kenë akses të shohin dhe të konsultojnë, qoftë edhe nga kompjuteri i shtëpisë, llogarinë e tyre, përsa i përket kontributeve të paguara në kohë reale. Përveç rritjes së transparencës do të shmangen burokracitë në pajisjen e kontribuesve me dokumentat dhe vërtetimet përkatëse për kontributet e paguara, si dhe do të ulët presioni ndaj punëdhënësve për deklarimin real të numrit dhe pages;
- Shkurtimin e kohës së caktimit dhe llogaritjes së përfitimeve dhe rritje e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve;
- Shmangien e burokracisë në lidhje me dokumentat që duhen dorëzuar për caktimin e përfitimeve. Të gjitha dokumentat që qytetarët sjellin sot për të përfituar do të jenë të dixhitalizuara (imazhe dhe digite) dhe nuk do të jetë nevoja që një qytetar të rendë për t'i mbledhur ato;
- Pagimin online dhe kontrollin në kohë reale të pagesave të pensioneve dhe përfitimeve të tjera. Krjimi i bazës të të dhënave të pensioneve krijon mundësinë e hartimit të listëpagesave mujore dhe përdorimin e programeve përkatëse për evidentimin e saktë të pagesave në kohë reale;
- Unifikimin dhe saktësimin e statistikave të personalizuar në çdo moment. Kjo do të realizohet nëpërmjet qendërimit të informacionit, lidhjes dhe komunikimit online me të gjitha database;
- Kontabilizimin automatik të pensioneve në sistemin financiar. Kjo do të realizohet edhe gjatë pagimit online të pensioneve, duke rritur mirëadministrimin e financave të sigurimeve shoqërore dhe kontrollin e transfertave në drejtim të agjentëve pagues;
- Kontabilizimin e të ardhurave nga kontributet në një kohë shumë të shkurtër;

Realizimi me sukses i kësaj strategjie ka qenë dhe mbetet sfidë për institucionin tonë në të gjitha drejtimet, pasi është një rrugë e pashkelur më parë.




## ARKIVI QENDROR I SIGURIMEVE SHOQËRORE

Ngritja e Arkivit Qendror të sigurimeve shoqërore përbën një hap të rëndësishëm drejt menaxhimit dhe dixhitalizimit të dokumentacionit të vjetërsisë në punë. Mbështetur në nenin nr. 74, shkronja” e”, “b/1”, të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 761, datë 19.11.2004 “Për krijimin e Arkivit Qendror për sistemimin, ruajtjen dhe shfrytëzimin e dokumentacionit të periudhës së sigurimit pranë Institutit të sigurimeve shoqërore” dhe për zbatimin në vijimësi të rekomandimeve të projektit të Komisionit Europian “Mbështetje për modernizimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 3, datë 04.03.2011 miratoi Rregulloren nr. 8 “Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore”.



Në zbatim të vendimeve dhe rregulloreve, gjatë vitit 2011 u intensifikua puna për grumbullimin e dokumentacionit të vjetërsisë në punë si në qendër ashtu edhe në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore. U hartuan dhe u zbatuan programe pune për marrjen në dorëzim, përpunimin, certifikimin dhe dixhitalizimin e dokumentacionit të sigurimeve shoqërore. Për realizimin e këtyre programeve përveç punonjësve në organikë u aktivizuan dhe një numër i caktuar punonjësish provizorë. U realizua transferimi i bazës së të dhënave të regjistrave të kooperativave bujqësore në 10 Drejtori Rajonale të Sigurimeve Shoqërore: Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Kukës, Lezhë, Shkodër, Tiranë dhe Vlorë. Gjithashtu, në këtë kuadër, përfundoi dhe çertifikimi e dixhitalizimi i 84.4% të sasisë së përgjithshme të regjistrave të dorëzuar dhe krijimi i bazës së të dhënave. Kjo ka mundësuar që arkivat rajonale t'i shërbejnë në kohë dhe me cilësi të gjithë kërkesave të personave të interesuar për vjetërsi në punë të kooperativave bujqësore.

Procesi i dixhitalizimit të dokumentacionit dhe transferimi në rajone



Përpunimi i dokumentacionit të vjetërsisë në punë i marrë nga Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, bëri që specialistët e Drejtorisë së Arkivit të përballojnë një numër të madh kërkesash nga ana e qytetarëve. Me transferimin e kësaj baze të dhënash në rajonet respektive numri i kërkesave për verifikim pësoi rënie.

## AKTIVITETI FINANCIAR

### Administrimi Financiar

#### Plotësimi i objektivave kryesorë financiarë

Veprimtaria financiare e Institutit të Sigurimeve Shoqërore është fokusuar gjithmonë në drejtim të zbatimit të politikave të Qeverisë në fushën e pensioneve, në drejtim të përmirësimit thelbësor të administrimit të sistemit të përfitimeve, në krijimin dhe përditësimin e bazave të të dhënave si në fushën e pensioneve ashtu edhe në atë të kontributeve, në rritjen e cilësisë së administrimit të fondeve dhe kontrollit të brendshëm.

Puna për realizimin e këtyre objektivave dhe bashkëpunimi në vazhdimësi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, kanë bërë të mundur që për vitin 2011:

- Të ardhurat në fondin e sigurimeve shoqërore, për sigurimet shoqërore të detyrueshme dhe suplementare, të realizohen me 48,397 milionë lekë, nga 50,010 milionë lekë të programuara, me një diferencë prej 1,613 milionë lekë ose 96.8%. Vlen të theksohet se gjatë këtij viti janë mbledhur 3,202 milionë lekë më shumë se gjatë vitit 2010;
- Realizimi i tërheqjes së plotë të transfertës nga Buxheti i Shtetit, e programuar për fondin e sigurimeve shoqërore, në shumën prej 37,424 milionë lekë, duke bërë të mundur financimin e shpenzimeve për të gjithë programet financiare;
- Shpenzimet e fondeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore u mbyllën në masën 98.4% ose nga 86,734 milionë lekë të programuara, u realizuan 85,316.9 milionë lekë, me një mosrealizim prej rreth 1,417 milionë lekë. Krahasuar me një vit më parë, si pasojë e rritjes së masës së përfitimeve nga skema e detyrueshme dhe suplementare për vitin 2011 dhe i efekteve mbetëse të rritjes së masës së pensioneve në vitin 2010, transfertat e përgjithshme në buxhetet familjare u realizuan me 5,827 milionë lekë më shumë;


- Shpenzimet janë mbajtur nën kontroll për të gjitha skemat dhe programet. Në skemën e detyrueshme ato u realizuan 99.1%, në skemat suplementare 89.4% dhe në programet e veçanta të shtetit 99.8%;
- Në mënyrë të veçantë është bërë kujdes për respektimin e treguesve të programuar për shpenzimet administrative korente apo edhe për investime, ku programi u realizua në masën 88.7%. Nga 1,865 milionë lekë të programuara, janë shpenzuar 1,652.6 milionë lekë, me një mosrealizim prej 210.4 milionë lekë. Kostoja e administrimit të sistemit zë 1.97% të shpenzimeve nga deri në 5% të shpenzimeve që parashikohet si kufi nga ligji i sigurimeve shoqërore.

Krahasuar me vitin 2010, si pasojë e rritjes së masës së pensioneve në muajin Korrik 2011 dhe të efekteve mbetëse të rritjes së masës së pensioneve në vitin 2010, transfertat e përgjithshme në buxhetet familjare vetëm për përfitimet nga skema e detyrueshme nga viti 2005 deri në vitin 2011 janë rritur si më poshtë:

në milionë lekë

	2010	2011
Transferta në buxhetet e pensionistëve	74,391	78,775
Rritja në vlerë ndaj vitit të mëparshëm	5,257	4,384
Rritja në %	7.6	5.9

#### Ecuria e transfertave në buxhetet familjare në periudhën 2005 – 2011



#### Zbatimi i buxhetit

Siç përmendëm edhe më lart, limitet e shpenzimeve të miratuara për vitin 2011 janë ndjekur e respektuar gjatë të gjithë vitit. Në përfundim, në total, shpenzimet faktike krahasuar me programin u realizuan në masën 98.4% ose nga 86,734 milionë lekë të programuara, u realizuan 85,316.9 milionë lekë, me një mosrealizim prej rreth 1,417 milionë lekë.

## Shpenzimet e vitit 2011 të shprehura në mënyrë analitike

në milionë lekë

	plani i ndryshuar	fakti 12mujori	ndryshimi plan/fakt	%
I Shpenzime për përfitime	70,343.5	69,736.7	-606.8	99.1
1 Sëmundje	352.6	363.9	11.3	103.2
2 Barrë lindje	1,871.0	1,890.7	19.7	101.1
3 Pensione	68,100.9	67,470.5	-630.4	99.1
pensione urbane	55,022.5	54,511.4	-511.1	99.1
pensione rurale	13,078.3	12,959.1	-119.2	99.1
4 Aksidente në punë	19.0	11.6	-7.4	61.1
II Shpenzime për programe të veçanta të qeverisë	9,055.5	9,038.2	-17.3	99.8
III Shpenzime administrative	1,863.0	1,652.6	-210.4	88.6
IV Shpenzime për skemat suplementare	5,472.0	4,889.4	-582.6	89.4
<b>Totali i shpenzimeve</b>	<b>86,734.0</b>	<b>85,316.9</b>	<b>-1,417.10</b>	<b>98.4</b>

Siç konstatohet edhe nga tabela e mësipërme, 98% e shpenzimeve totale të Institutit të Sigurimeve Shoqërore përbëhet nga transfertat në buxhetet familjare të cilat janë edhe në fokusin kryesor të administrimit dhe të veprimtarisë drejtuese të Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Përgjithësisht shpenzimet janë mbajtur nën kontroll dhe brenda niveleve të programuara ndërkohë problematike vazhdojnë të mbeten nivelet e rritjes së shpenzimeve për pensionet e invaliditetit, ku vazhdon të konstatohet një rritje e përvitshme e numrit të invalidëve të rinj. Ndërsa shpenzimet e administrimit nga 1,863 milionë lekë të programuara janë realizuar 1,652.6 milionë lekë, me një mosrealizim prej 210.4 milionë lekë. Në këtë artikull të programit të shpenzimeve, me mosrealizime paraqiten të tre zërat bazë të shpenzimeve të administrimit si dhe nënzërat e tyre.

### Bilanci të ardhura-shpenzimeve dhe rezultati financiar

Bashkëveprimi dhe koordinimi i punës me Ministrinë e Financave për mbulimin e deficiteve të kontributeve nga sektorët privatë në qytet, rezultati pozitiv në të ardhurat nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi, mbledhja, realizimi dhe tejkalimi i të ardhurave të tjera dhe në veçanti, impenjimi i plotë dhe drejtimi i fokusuar për realizimin e të ardhurave të muajit dhjetor, kanë bërë të mundur që rezultati financiar i përgjithshëm i sigurimit shoqëror të detyrueshëm dhe suplementar të jetë me një tejkalim të të hyrave (të ardhurave) mbi shpenzimet në shumën 503 milionë lekë.



## Bilanci i të ardhura-shpenzimeve dhe rezultati financiar i sigurimeve shoqërore të detyrueshme e suplementare, në mënyrë analitike dhe të krahasueshme me buxhetin e vitit 2012

në milionë lekë

	Plan	Fakt	Ndryshimi	%
<b>I Skema e detyrueshme</b>				
a Të ardhura	81,262	79,987	-1,275	98.4
Nga kontributet	49,730	47,755	-1,975	96
Transfertë nga buxheti i shtetit	31,532	32,232	700	102.2
b Shpenzimet	81,262	80,331	-931	98.9
<b>II Skemat suplementare</b>				
a Të ardhura	5,472	5,833	338	106.6
Nga kontributet	280	641	338	220.7
Transfertë nga buxheti i shtetit	5,192	5,192	0	100
b Shpenzimet	5,472	4,986	-486	91.1
<b>III Gjithsej</b>				
